

ATLANTIK sh.a.

Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(me raportin e audituesit te pavarur bashkëlidhur)

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TE TJERA PËRMBLEDHËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-35
SKEDULE SUPLEMENTARE	i-ii



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Aksionarëve të
ATLANTIK Sh.a.

Tirana, 27 korrik 2015

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar e pasqyrat financiare bashkëngjitur të ATLANTIK Sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014, pasqyrat e fitim humbjeve dhe e të ardhurave të tjera përmblendhëse, ndryshimet në kapital dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet, që përfshijnë një përmblendhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin e kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të kualifikuar.

Bazat për Opinionin e Kualifikuar

1. Informacioni që Shoqëria na siguroi për të testuar mjaftueshmërinë e detyrimit për humbjet e ndodhura por të paraportuara ("IBNR") dhe korrigjimeve për humbje më 31 dhjetor 2014 për produktet e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike nuk ishte i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm.

Duke përdorur praktika ndërkombëtare aktuariale të mjaftueshme dhe të përshtatshme, rezerva IBNR më 31 dhjetor 2014 do të kishte qene me e larte. Ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim as rezervën e mundshme shtese të IBNR, as efektin që do të rezultonte mbi marzhin e aftësisë paguese dhe raportin e aktiveve në mbulim të provigjioneve bruto teknike dhe matematikore të raportuara nga Shoqëria ndaj provigjioneve teknike bruto.

2. Informacioni që Shoqëria na siguroi për të vlerësuar testin e mjaftueshmërisë së detyrimeve ("LAT") për rezervën teknike më 31 dhjetor 2014 për produktin TPL sipas kërkesave të SNRF 4, "Kontrata e Sigurimit" përfshinte një vlerë më të ulët të dëmeve të pritshme në lidhje me aktivitetin ekzistues sesa vlera që do të rezultonte nga përlllogaritjet e pavarura. Bazuar në analizat tona, niveli i dëmeve IBNR në lidhje me dëmet e ndodhura në 2014 të marra në konsideratë nga Shoqëria ishte më i ulët se shumta e pritshme bazuar në përlllogaritjet tona të pavarura. Shoqëria nuk përfshiu në llogaritje as shpenzimet e ardhshme të trajtimit të dëmeve.

Ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë shumën e mundshme për korrigjim në lidhje me kostot e shtyra të marrjes në sigurim dhe rezervën e rrezikut të paskaduar dhe rrjedhimisht ndaj fitimit të vitit dhe fitimit të akumuluar, as efektin që do të rezultonte mbi marzhin e aftësisë paguese dhe raportin e aktiveve në mbulim të provigjioneve bruto teknike dhe matematikore të raportuara nga Shoqëria ndaj provigjioneve teknike bruto.

3. Të arkëtueshmet nga sigurimet dhe aktivet e tjera të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014 arrijnë 96,035,219 Lek dhe 102,224,606 Lek pas zhvlerësimit, nëse ka. Një pjesë e këtyre të arkëtueshmeve dhe aktiveve, në shumën 28,156,815 Lek dhe 26,440,153 Lek janë me vonesë prej më shumë se një viti dhe për të cilat nuk është parashikuar zhvlerësim. Megjithatë janë marrë një sërë masash nga Shoqëria për mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe aktiveve me vonesë, sipas këndvështrimit tonë, të arkëtueshmet nga sigurimet dhe aktivet e tjera janë të mbivlerësuara në fund të vitit 31 dhjetor 2014.

Nëse Shoqëria do të kishte aplikuar rregullimet të cilat reflektojnë zhvlerësimin, të arkëtueshmet nga sigurimi dhe aktivet e tjera më 31 dhjetor 2014 do të ishin më të ulëta, dhe humbjet nga zhvlerësimi për vitin do të ishin më të larta. Ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë shumën shtesë të zhvlerësimit për të cilën vlera e mbetur e të arkëtueshmeve nga sigurimet dhe aktivet e tjera duhet të ishin zvogëluar, si dhe efektin që rezulton në marzhin e aftësisë paguese dhe raportin e aktiveve për mbulimin e detyrimeve të sigurimit, të raportuara nga Shoqëria ndaj provigjioneve teknike bruto.

4. Siç është paraqitur në skedulet suplementare të pasqyrave financiare, Shoqëria ka llogaritur marzhin e aftësisë paguese dhe aktivet për mbulimin e provigjioneve bruto teknike dhe matematikore më 31 dhjetor 2014. Siç paraqitet në paragrafët e mëparshëm, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë ndikimin e efekteve të çështjeve të përshkruara më sipër mbi marzhin e aftësisë paguese dhe raportin e aktiveve për mbulim të detyrimeve të sigurimit ndaj provigjioneve teknike bruto në fund të vitit.

Opinionin e Kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në paragrafët Bazat e Opinionit të Kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2014, të rezultatit të tij financiar dhe të flukseve të tij monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje për t'u theksuar

Pa e modifikuar më tej opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për si më poshtë:

- Aktivitet për mbulim të provigjioneve bruto teknike dhe matematike më 31 dhjetor 2014 janë vetëm 76% e rezervave teknike krahasuar me minimumin e kërkuar prej 100% duke rezultuar me një shumë të pambuluar të rezervës prej 114,663 mijë Lek. Këto rrethana, së bashku me çështje të tjera të paraqitura sipas shënimit 2 të pasqyrave financiare, tregojnë ekzistencën e një paqartësie materiale, e cila mund të shkaktojë dyshime mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë.
- Shënimi 33 i pasqyrave financiare të përshkruan detyrimin ligjor të Shoqërisë lidhur me kontributin për fondin e kompensimit të MTPL. Më 20 Maj 2015, Byroja Shqiptare e Sigurimit raportoi pjesën e fondit të kompensimit për 2015 për secilën nga shoqëritë e sigurimit në Shqipëri e cila paraqiste një detyrim ligjor të Shoqërisë prej Lek 41 milion për dëmet e vjetra. Kjo është shoqëruar nga një letër e datës 29 Maj 2015 i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare duke i kërkuar Shoqërisë njohjen e një provigjioni në këto pasqyra financiare për pjesën e fondit të kompensimit për dëmet e vjetra, për 2015 dhe 2016. Gjithsesi, Shoqëria e ka konsideruar letërën jo ligjërish të detyrueshme dhe për më tej ka vlerësuar se ka një pasiguri të konsiderueshme për shumën që duhet të paguhet për dëmet e vjetra të fondit të kompensimit për 2015 dhe 2016. Rezultati përfundimtar i çështjes nuk mund të përcaktohet aktualisht dhe si rrjedhojë, asnjë provigjion për pjesën e 2015 dhe 2016 të fondit të kompensimit të dëmeve, nuk është njohur në pasqyrat financiare.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 u audituan nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të kualifikuar më 23 Maj 2014 për shkak të: 1) mungesa e evidencës së mjaftueshme mbi arkëtueshmerinë e shumës prej 190,748,860 Lek në lidhje llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera dhe mungesa e evidencës së mjaftueshme në lidhje me balancën e inventarit në shumën 31,723,895 Lek; 2) mungesa e evidencës së mjaftueshme në lidhje me balancën e detyrimeve ndaj aksionarit 5,075,655 Lek dhe 3) mosnjohja e detyrimit për fondit të kompensimit në lidhje me vitin 2014 në shumën 56,324,000 Lek në bazë të njoftimit të dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe mungesa e evidencës së mjaftueshme në lidhje me detyrimin e fondit të kompensimit për tu paguar në vitet 2015 dhe 2016.



Raporte për rregullatorë të tjerë – kërkesë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë për Marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike

Në vijim të kërkesave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, ne kemi lexuar Skedulet Suplementare bashkëlidhur për Marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktivët në Mbulim të Rezervave Teknike ("Skedulet Suplementare"). Këto Skedule Suplementare të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e pasqyrave financiare bashkangjitur. Informacioni financiar historik, i paraqitur në Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, është i qëndrueshëm, përveçse për efektet e mundshme të çështjeve të përshkruara në Bazat për Opinion të Kualifikuar, në të gjitha aspektet materiale me informacionin financiar vjetor, pasqyruar në pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë më 31 dhjetor 2014, përgatitur në përputhje me legjislacionin kombëtar të kontabilitetit, i aplikueshëm për shoqëritë e sigurimit në Shqipëri. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skeduleve Suplementare, në përputhje me Ligjin nr. 52 datë 22 maj 2014 "Për Veprimtarinë e Sigurimit, të Risigurimit dhe Ndërmjetësimit në Sigurime dhe Risigurime".

Fatos Beqja
Auditues Ligjor

KPMG Albania Sh.p.k.
"Deshmoret e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

	Shënime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
AKTIVET			
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	7	11,976,098	7,012,054
Depozita me afat	8	523,719,505	494,113,496
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	9	96,035,219	127,186,819
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim	10	95,813,526	63,278,927
Aktive të risigurimit	11	13,334,505	7,203,535
Prona dhe paisje	13	24,040,825	29,819,950
Aktive të patrupezuara	14	1,943,080	2,568,994
Investimet në Ndertesa	12	429,494,685	445,497,508
Parapagime ndaj paleve të lidhura		1,392,105	-
Aktive të tjera	15	102,224,606	95,285,936
TOTALI AKTIVEVE		1,299,974,154	1,271,967,219
DETYRIMET			
Detyrime për humbjet dhe shpenzimet e axhustimit të humbjeve	16	148,670,352	182,395,941
Rezerva për primet e pafituara	17	335,544,367	219,323,725
Detyrime ndaj risigureseve	18	27,020,152	26,561,303
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	19	147,664,095	211,643,686
Tatim fitimi i pagueshem	20	14,945,343	14,945,343
Te pagueshme ndaj paleve të lidhura	21	-	103,453,655
TOTALI I DETYRIMEVE		673,844,309	758,323,653
KAPITALI			
Kapitali themeltar	22	756,108,491	657,730,491
Rezerva të riskut të sigurimit	23	16,891,912	16,891,912
Humbje të mbartura		(146,870,558)	(160,978,837)
TOTALI I KAPITALIT		626,129,845	513,643,566
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,299,974,154	1,271,967,219

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtuesit e Shoqërisë më 27 Korrik 2015 :

Dritan Çelaj
Drejtues i përgjithshëm

Juliana Bitro
Drejtues Finance

Atlantik Sh.a.**Pasqyra e fitim ose humbjeve dhe të ardhurave përmbledhëse të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	2014	2013
Prime të shkruara bruto	24	689,623,081	385,230,776
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	17	(113,554,983)	62,137,177
Prime të ceduara risiguruesve	25	(17,073,700)	(39,377,028)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		558,994,398	407,990,925
 Të ardhura të tjera	26	53,797,181	5,009,653
Të ardhura neto		612,791,579	413,000,578
 Humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes	16	(240,434,500)	(263,941,534)
Dëme të sigurimit neto		(240,434,500)	(263,941,534)
 Kostot e marrjes në sigurim	27	(201,975,485)	(118,575,418)
Ndryshimi në kostot e shtyra të marrjes në sigurim		32,534,599	(13,088,878)
Shpenzime administrative	28	(198,596,629)	(218,122,422)
Shpenzime të tjera të sigurimit	29	(8,611,699)	(10,339,220)
Humbje operative		(376,649,214)	(360,125,938)
 Të ardhura nga interesi	30	11,582,717	20,452,724
Shpenzime financiare		(721,664)	(3,085,174)
Të ardhura nga kurset e këmbimit	31	7,539,361	(1,063,317)
Të ardhura financiare neto		18,400,414	16,304,233
 Fitimi/(humbja) para tatimit		14,108,279	(194,762,661)
 Tatimi mbi fitimin	32	-	-
 Fitimi/(humbja) e vitit		14,108,279	(194,762,661)
 Të ardhura përmbledhëse të tjera		-	-
Totali i të ardhura/(humbjeve) përmbledhëse të vitit		14,108,279	(194,762,661)

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Atlantik Sh.a.**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Kapitali themeltar	Rezerva	Fitime/(humbje) të mbartura	Total
Gjendja më 1 Janar 2013	628,336,081	7,126,033	43,549,703	679,011,817
Kontributi i aksionarit ne para	29,394,410	-	-	29,394,410
Rrimarje e rezerves se riskut te sigurimit	-	(7,126,033)	7,126,033	-
Rritje e rezerves se riskut te sigurimit	-	16,891,912	(16,891,912)	-
Transaksione me pronarët, te njohura direkt ne kapital	29,394,410	9,765,879	(9,765,879)	29,394,410
Humbja e vitit	-	-	(194,762,661)	(194,762,661)
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit, neto nga tatimi	-	-	(194,762,661)	(194,762,661)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	657,730,491	16,891,912	(160,978,837)	513,643,566
Kontributi i aksionarit nëpërmjet konvertimit të detyrimit	98,378,000	-	-	98,378,000
Rritje e rezerves se riskut te sigurimit	-	-	-	-
Transaksione me pronarët, te njohura direkt ne kapital	98,378,000	-	-	98,378,000
Fitimi i vitit	-	-	14,108,279	14,108,279
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit, neto nga tatimi	-	-	14,108,279	14,108,279
Gjendja më 31 dhjetor 2014	756,108,491	16,891,912	(146,870,558)	626,129,845

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Atlantik Sh.a.**Pasqyra e fluksit të parasë për për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	2014	2013
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi/(humbja) para tatimit	14,108,279	(194,762,661)
Rregullime për:		
Amortizimi i aktiveve	29,936,515	32,534,750
Nxjerrja jashtë përdorimit	13,232,702	-
Provigjon për boxhin e keq	-	6,978,381
Fshirje e llogarive të arketueshme, të provigjionuara me pare	-	(59,234,841)
Te ardhura nga interesi	(11,582,717)	(20,452,724)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative para ndryshimit në aktivet dhe detyrimet operative	45,694,779	(234,937,095)
<i>Ndryshimi në aktivet dhe detyrimet operative:</i>		
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit	31,151,600	100,064,075
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	(32,534,599)	13,088,878
Ndryshimi në aktivet e risigurimit	(6,130,970)	72,859,735
Ndryshimi në parapagime ndaj paleve të lidhura	(1,392,105)	-
Ndryshimi në aktive të tjera	(6,938,670)	(29,047,820)
Ndryshimi në rezervën teknike për dëme	(33,725,589)	(45,867,167)
Ndryshimi në rezervën e primit	116,220,642	(62,856,884)
Ndryshimi në detyrimin nga risuguruesi	458,850	(8,303,519)
Ndryshimi në detyrimet nga sigurimi dhe të tjera	(63,979,591)	28,134,185
Ndryshimi në detyrime ndaj paleve të lidhura	(5,075,655)	103,453,655
Tatimi mbi fitimin i paguar	-	-
Interesi i arketuar	17,128,892	19,112,067
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	60,877,584	(44,299,890)
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje pronash dhe paisje	(761,355)	(512,266)
Blerje investime në ndertesa	(20,000,000)	-
Blerje aktive të patrupezuara	-	(768,600)
Rritje në depozitat me afat	(35,152,185)	6,431,391
Flukset monetare të (përdorur në) /gjeneruara nga aktivitetet investuese	(55,913,540)	5,150,525
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Rritje e kapitalit aksionar	-	29,394,410
Flukset monetare të përdorura nga aktivitetet financuese	-	29,394,410
Rritje/(ulje) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to	4,964,044	(9,754,955)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	7,012,054	16,767,009
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit (Shënimi 7)	11,976,098	7,012,054

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. General information

Atlantik Sh.a (“Shoqëria”) u krijua me 3 prill 2000 si një shoqëri sigurimesh e vendosur në Shqipëri dhe u licensa me 2 maj 2001 nga Autoriteti i Mbikqyrjes së Sigurimeve. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë ofrimin e shpërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pasuritë, shëndetin dhe një sërë sigurimesh të tjera jo-jetë. Shoqëria ka 13 degë në Tiranë, Diber, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokaster, Korçë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Shkoder dhe Vlorë.

Tregu i sigurimeve në Shqipëri rregullohet nga ligji nr. 52 datë 22 Maj 2014 “Mbi aktivitetin e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetsimit në sigurim dhe risigurim” në Republikën e Shqipërisë (në vijim shprehur si “Ligji i Sigurimit”). Entiteti rregullator është Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (në vijim “Autoriteti”)

Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në Rr. Themistokli Gërmenji, Nr.3/1, Tiranë, Shqipëri. Në 31 dhjetor 2014 Shoqëria ka 109 punonjës, staf i thjeshtë dhe menaxherial (2013:99)

2. Bazat e përgatitjes

a) Bazat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

d) Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykit profesional

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe në periudha të ardhshme që rishikimi ndikon. Më në veçanti, informacione në lidhje me vlerësimet e pasigurta dhe gjykimet profesionale në aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet 10, 18 dhe 19.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshëm dhe relevant për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhëshme.

2. Bazat e pregtitjes (vazhdim)

d) Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional (vazhdim)

Pretendimet dhe përfitimet e policë-mbajtësit

Vlerësimi i detyrimeve që lindin nga dëme të ndodhura nga kontratat e sigurimeve është vlerësimi kontabël më kritik i Shoqërisë. Vendimi i Shoqërisë për humbjet e raportuara dhe të paraportuara dhe vendosja e reserves dhe rimarrja nga risigurimet, rishikohen dhe përditësohen cdo vit, dhe ndryshime që rezultojnë nga ky vlerësim pasqyrohen në humbjet ose fitimet. Procesi nuk mbështetet në supozimin që eksperiencat e mëparshme të rregullara për efektet e zhvillimeve dhe trendave aktualë, është një bazë e besueshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme.

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera njihen me kosto duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Vlerësimi i zbritjeve për humbjet nga zhvlerësimi është gjithashtu një vlerësim kritik i realizuar nga menaxhimi. Në cdo datë raportimi bëhet një vlerësim nëse llogaritë e arkëtueshme të sigurimit duhet të zhvlerësohen. Normalisht, llogaritë e arkëtueshme të sigurimit me më shumë se një vit vonesë zhvlerësohen plotësisht, më përjashtim nëse ka një probabilitet të lartë që do të arkëtohen. Ky probabilitet ekziston nëse Shoqëria ka marrëdhënie afatgjata me klientët ose kur Shoqëria blen të mira dhe shërbime nga i siguruari dhe të arkëtueshmet përcaktohen si shumë neto. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit me vonesë më pak se një vit vlerësohen individualisht në rastet kur ato kanë vlerë të konsiderueshme dhe zhvlerësohen plotësisht nëse ekzistojnë informacione që nuk do të mblidhen. Llogaritë e arkëtueshme me vonesë më pak se një vit vlerësohen gjithashtu në grup duke u bazuar në vjetërsinë e tyre. Përqindja e provigjionit që aplikohet për cdo kategori vjetërsie të llogarive të arkëtueshme me vonesë më pak se një vit përfaqëson vlerësimin më të mirë të menaxhimit mbi humbjet e ardhshme dhe bazohen mbi experiencat e rimarrjes së viteve të mëparshme dhe të eksperiencave të tregut.

Parimi i vijishmerisë

Shoqëria po punon për të rritur fitimet e saj përmes rritjes së shitjeve dhe përmirësimit të marzheve bruto dhe operacionale. Drejtimi i Shoqërisë siguron që do vazhdojnë të mbështet nga Aksioneri dhe beson që veprimtaria operative e saj do të jetë dhe në vijimësi.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit njihen në të ardhura ose humbje.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**(b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit dhe investimeve (detyrimet)**

Produktet e sigurimit të Shoqërisë klasifikohen në momentin e krijimit, për arsye kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose pushojnë së ekzistuari.

Kontrata nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja sigurore) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e cmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

(c) Kontratat e sigurimit (detyrimet)**(i) Njohja dhe matja e kontratave***Kontratat e përgjithshme të sigurimit*

Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të vecantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituara), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provigjonet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Shoqëria nuk i skanton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Shoqëria ka përdorur kërkesat e legjislacionit shqipëtar të sigurimeve për të përcaktuar detyrimet e sigurimit.

Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimi

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma mund ti perkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe nuk përfshijnë tatimet dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

Rezerva për primin e pafituar

Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet të fitohet në vitin financiar pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale 1/365, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë cdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Megjithatë të gjitha produktet e Shoqërisë kanë rrezik linear dhe asnjë rregullim për ndryshime të rrezikut nuk është bërë.

Primi i pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e nënshkruara të cilat prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet dhe detyrimet doganore të bazuara tek primet. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim njihen më vete si aktive.

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

c) Kontratat e sigurimit (detyrimet) (vazhdim)

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë pjesa e kostove të marrjes në sigruim të cilat zbriten gjatë llogaritjes së rezervës së primit të pafiturar. Ato përcaktohen si pjesë e kostove të blerjes të vendosura si përqindje në planin teknik të sigurimit dhe lidhen me periudhën midis fundit të periudhës së raportimit dhe datës së shuarjes së kontrates së sigurimit. Kostot aktuale të marrjes në sigurim njihen plotësisht si shpenzime të periudhës.

Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura përbëhen nga kostot e mbylljes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarje të ndodhura gjatë vitit financiar sëbashku me rregullime të provigjonit të dëmeve të vitit të mëparshëm. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, dëmet e refuzuara gjithashtu njihen si pjesë e dëmeve të papaguara për një periudhë 2-vjeçare.

Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke provigjonuar dëmet e ndodhura por ende të paraportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara të brendëshme dhe të jashtëme, të tilla si ndryshimet e procedurave në trajtimin e dëmeve, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legjislative dhe eksperiencat e mëparëshme. Provigjoni për dëmet e papaguara nuk skontohej. Rregullimet për provigjonin e dëmeve të viteve të mëparëshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale.

Nderkohë që Bordi i Drejtorëve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe marrjet nga risigurimi janë të drejta, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në një rregullim të shumës së dhënë. Rregullimet për detyrimet e sigurimit reflektohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën bëhet rregullimi.

Angazhimet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë në proces gjyqësor dhe për të cilat Shoqëria ka regjistruar detyrimin përkatës në bazë të vlerësimeve të drejtimit.

ii) Risigurimi

Shoqëria cedon primet e siguruara dhe rrezikun në rrjedhën normale të biznesit me potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linjat e biznesit të MTPL dhe pasurisë.

Risigurime të tilla përfshijnë tejkalimin e humbjeve nga marreveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe atij kohor regjistrohen si aktive të sigurimit. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë shoqërinë nga detyrimet direkte ndaj policëmbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtëme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur u mbaron afati.

Primet e risiguruara për risigurimin e ceduar njihen si shpenzim në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për sigurimin e përgjithshëm të biznesit, primet e risigurimit shpenzohen në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguruar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në aktivet e risiguruara. Shuma e njohur si aktiv i risiguruar matet në mënyrë që të jetë konsistente me matjet e provigjonit të mbajtur në përputhje me kontratat e sigurimit.

Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara risiguresit dhe të arkëtueshmet nga Shoqëria risiguresuese në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të vecanta, nëse ka.

Aktivitet e risiguruara vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive, si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Shoqëria mund të mos marrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe ngjarja ka një impakt besueshmërisht të matshëm në shumat që Shoqëria do të marrë.

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Kontratat e sigurimit (detyrimet) (vazhdim)

iii) Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në cdo datë raportimi Shoqëria bën një test të mjaftueshmërisë të rezervave të dëmeve. Testet e para që realizohen janë Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provigjioneve të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve realizohet çdo vit në mënyrë individuale për linjat kryesore të biznesit. Llogaritjet realizohen më vete për dëmet si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjeve si dhe kosto të tjera të jashtëme për trajtimin e dëmeve. Në realizimin e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë vleresimet aktuale të fluksve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skonton këto flukse monetare pasi pjesa më e madhe e dëmeve priten të zgjidhen brenda një viti.

Për më tepër, Shoqëria kryen çdo vit analizën e zhvillimit të provigjioneve të dëmeve për të përcaktuar metodologjinë e rezervës. Kjo analize kryhet në mënyrë të vecantë por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Në rastet kur analiza paraqet parregullsi të theksuara, rregullime të caktuara i bëhen metodologjisë së rezervës. Nëse një mungesë identifikohet ajo i alokohet fitimit ose humbjes duke krijuar një provigjon për rrezikun e paskaduar nga humbjet që lindin nga testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve.

(d) Instrumentet Financiare

i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, të arkëtueshmet dhe huatë në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e transaksionit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

ii) Klasifikimi

Shiko politikat kontabël 3.(e),(f),(g).

iii) Ç'regjistrimi

Shoqëria ç'regjistron një aktiv financiar nëse humbet të drejtat kontraktuale mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhet, anulohen ose maturohen.

Shoqëria hyn në transaksione përmes të cilëve transferon aktivet të njohura në pasqyrat e pozicionit financiar, por mban ose të gjithë rrezikun ose përfitimet e aktivit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose pothuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëhere aktivet e transferuara nuk ç'regjistrohen nga pasqyrat e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve që shoqërohet me mbajtjen e të gjitha ose pothuajse të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve përfshin për shembull, transaksionet e riblerjes dhe kreditimin e letrave me vlerë.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(d) Instrumentet Financiare (vazhdim)

iv) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka për qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

v) Matja e koston së amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv për ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiare në tregjet aktive. Për të gjithë instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregjet aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në cdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivitet financiarë pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivitetit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e ardhëshme monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup. Të gjitha aktivitet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë. Të gjitha aktivitet e rëndësishme që nuk konsiderohet të kenë rënë në vlerë vlerësohen më pas kolektivisht për ndonjë rënie në vlerë që ka ndodhur por nuk është identifikuar. Aktivitet që individualisht nuk janë të rëndësishme grupohen dhe vlerësohen së bashku për rënie në vlerë me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar).

Si evidencë objektive për rënie të mundshme në vlerë të aktiveve mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar; tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

(e) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

(f) Depozitat me afat

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(g) Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më tej maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi dhe përfshijnë paratë e mbajtura nga agjentët. Të arkëtueshmet nga sigurimi vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

Të tjera

Aktivet e tjera financiare jo derivative maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3(m).

(h) Njohja e të ardhurave

i) Primet

Politikat kontabël në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit janë sqaruar në shënimin 3(c).

ii) Të ardhura nga qeraja

E ardhura nga qeraja njihet në bazë të të drejtave të konstatuara.

(i) Kostot e marrjes në sigurim dhe trajtimit të dëmeve

Kostot e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që lindin prej blerjes së kontratave të reja të sigurimit, përfshirë këtu kosto direkte si komisionet e blerjes dhe kostot e përpilimit të dokumentit të sigurimit, por edhe shpenzime të pjesshme administrative të lidhura me procesimin e propozimit dhe lëshimin e policës.

Kostot e trajtimit të dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzime të brendshme të mbulimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë të parëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Kostot direkte të marrjes në sigurim shtyhen përgjatë kohëzgjatjes së policës përmes një metode konsistente me llogaritjen e provigjionit të primit të pafiturar dhe paraqiten bruto nga detyrimi përkatës i sigurimit, si një aktiv. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim amortizohen sistematikisht përgjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Çdo shumë që nuk rimerret konsiderohet shpenzim.

(j) Shpenzimet

i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

ii) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat sigurojnë të ardhura pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit ligjor minimal për pensionet në kuadër të juridiksionit respektiv dhe planit të kontributeve të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë në planin e pensionit i ngarkohen pasqyrës së humbje fitimeve kur ato ndodhin.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**(l) Shpenzimet (vazhdim)****iii) Pagesat e qerasë operative**

Pagesat e bëra për qeratë operative njihen në pasqyrën humbje fitimeve me metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

(m) Të ardhura dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarrjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen bruto. Të ardhurat nga interesat njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(n) Prona dhe paisje**(i) Njohja dhe matja**

Ndertesat dhe pajisjet maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me koston e blerjes së aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka patur), çdo kosto tjetër drejtpërdrejt e atribuueshme që sjell aktivin në gjendjen e tij të parashikuar të punës, si dhe koston e çmontimit dhe zhvendosjes së aktivitetit dhe rikthimit të vendndodhjes së tij në gjendjen e mëparshme. Kur pjesët e një aktiviteti kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (komponentë kryesorë) të pajisjes.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të paisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brenda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kosto të mëtejshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërianë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Toka, parapagimet dhe aktivet në process nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i ndertesave dhe permiresimeve infrastrukturore realizohet përmes metodës lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivitetit, ndërsa zhvlerësimi i aktiveve të tjera realizohet përmes metodës së vlerës së mbetur aplikuar mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve. Normat e vlerësuar të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Ndërtesa dhe përmirësime të qeramarrjeve	5 %
Paisje zyre	20 %
Mjete motorrike	20 %
Kompjuterat dhe programe kompjuterike	25 %

Vlera e mbetur, nëse është e rëndësishme, rivlerësohet në mënyrë të përvitshme. Përmirësimet e qeramarrjeve kapitalizohen dhe zhvlerësohen për më të voglën midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qerasë. Veprat e artit nuk zhvlerësohen.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**(o) Investime ne ndertesa**

Investimet ne ndertesa fillimisht maten me kosto e cila perfshin edhe kostot e trasaksionit. Menjehere pas njohjes fillstare, investimet ne ndertesa maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi ne daten e raportimit. Investimet ne ndertesa cregjistrohen ne rastin kur ato nxirren nga perdorimi ose kur investimi ne ndertese nuk perdoret me dhe nuk priten me te ardhura nga nxjerrja e tij nga perdorimi.

Zhvlerësimi i investimeve ne ndertesa realizohet permes metodës së vlerës së mbetur mbi jetegjatesine e vlerësuar te aktivi. Jetegjatesia e vlerësuar e investimeve ne ndertesa eshte 20 vite.

(p) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, me përjashtim të aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperushme e aktivit.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose njësia e tij e gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përlllogaritjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë para efektit të taksës e cila reflekton vlerësimet momentale të tregut për vlerën në kohë të parasë si edhe rrisqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbja nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme rishikohet në çdo datë raportimi nëse ka tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi rikthehet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën, me të cilën vlera e mbartur e aktivit nuk do të tejkalonte vlerën e mbartur të tij e cila do të ishte përcaktuar si vlera neto pas amortizimit nese nuk do ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

(q) Tatimi

Shpenzimet e tatim fitimit përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Këto shpenzime njihen në humbje dhe fitime me përjashtim të rasteve kur njohja bëhet direkt në kapital apo të tjera të ardhura përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurën e tatueshme të vitit, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, si dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm të viteve të mëparshme. Primet e kthyera dhe rregullimet e mëvonshme të primeve zbriten prej primeve bruto për të arritur te baza e taksës.

Tatimi i shtyrë njihet për diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet përmes normave tatimore që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të rikthehen mbrapsht, bazuar në ligjet që janë në fuqi apo kryesisht në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën në të cilën është e mundur të ketë fitime të ardhshme të tatueshme përkundrejt të cilave të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në shkallën në të cilën nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të mund të realizohet.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(r) Standartet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime hyjnë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë pas datës 1 Janar 2014, megjithatë Shoqëria nuk ka aplikuar këto standarde dhe ndryshime në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Standarde të reja ose të amenduara	Përmbledhje e kërkesave	Ndikimi i mundshëm në pasqyrat financiare
SNRF 9 <i>Instrumentet Financiare</i>	SNRF 9, publikuar në Korrik 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues të SNK 39 <i>Instrumentet Financiare: Njohja dhe Vlerësimi</i> . SNRF 9 përfshin udhëzimin e rishikuar për klasifikimin dhe vlerësimin e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së planifikuar të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të përgjithshme të kontabilitetit për fondin rezervë. Ky standard jep udhëzime të mëtejshme në lidhjen me njohjen dhe mos-njohjen e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2018 dhe aplikimi i mëhershëm lejohet.	Shoqëria është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9. Për shkak të natyrës së operacioneve të Shoqërisë, ky standard pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
SNRF 15 <i>Të ardhurat nga kontratat me klientët</i>	SNRF 15 përcakton një kuadër gjithëpërfshirës për përcaktimin e njohjes së vlerës dhe kohën e njohjes. Ky standard zëvendëson standardin ekzistues udhëzues për njohjen e të ardhurave, përfshirë SNK 18 <i>Të ardhurat</i> , SNK 11 <i>Kontratat për Ndërtimin dhe IFRIC 13 Programet për Besnikërinë e Klientit</i> . SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2017 dhe aplikimi i mëhershëm lejohet.	Shoqëria është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 15

Standardet e reja apo të ndryshuara më poshtë nuk pritet të kenë efekt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- *Planet me Përfitime të Përcaktuara: Kontributet e Punonjësve (Ndryshime të SNK 19)*
- *Permiresimet e përvitshme të SNK për ciklin 2010-2012*
- *Permiresimet e përvitshme të SNK për ciklin 2011-2013*
- *SNRF 14 Llogaritë e Shtyra për arsye Rregullatore*
- *Kontabiliteti për Blerjet Interesave në Operacionet e Përbashkëta (Ndryshime të SNK 16 dhe SNK 38)*
- *Bujqësia: Bimët Prodhuese (Ndryshime të SNK 16 dhe SNK 41)*
- *Metoda e Kapitalit në Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshime të SNK 27)*
- *Shitjet ose Kontributet në Aktive ndërmjet një Investitori dhe Pjesëmarrjeve të tij apo Sipërmarrjeve të tij të Përbashkëta (ndryshime të SNRF 10 dhe SNK 28).*
- *Permiresimet e përvitshme të SNK për ciklin 2012-2014 – standarte të ndryshme.*

4. Përdorimi i Vlerësimeve dhe Gjykimeve

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve gjatë vitit financiar. Vlerësimet dhe gjykimet çmohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në informacionin e vlefshëm relevant të tregut dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë këtu pritshmëritë për ngjarje të ardhshme që besohen si të arsyeshme nën rrethanat e dhëna.

(i) Llogaritja e Detyrimeve të Sigurimit

Shiko shënimin 3.c

(ii) Njohja e detyrimeve ligjore për fondin e kompensimit të TPL-së

Shiko shënimin 33.

(iii) Përcaktimi i Vlerës së Drejtë

Politikat kontabël të Shoqërisë mbi llogaritjen e vlerës së drejtë diskutohen në politikat kontabël 3.d.(vi). Shoqëria llogarit vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë që reflekton rëndësinë e inputeve të përdorura në kryerjen e llogaritjeve:

- Niveli 1: Çmimi i tregut i kuotuar (i parregulluar) në një treg aktiv për një instrument identik

- Niveli 2: Teknika të vlerësimit të bazuara në inputet e observuara, qoftë direkt (p.sh. çmimet) qoftë indirekt (p.sh. të derivuar nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuara në tregjet aktive për instrumenta të ngjashëm; çmimet e kuotuara për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha inputet e rëndësishme janë të observueshme direkt ose indirekt nga të dhënat e tregut.

- Niveli 3: Teknika të vlerësimit që përdorin inpute të rëndësishme të paobservueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat për të cilët teknikat e vlerësimit janë bazuar në inpute të paobservueshme dhe ku inputet e paobservueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen bazuar në çmimet e kuotuara të instrumentave të ngjashëm ku rregullime apo supozime të rëndësishme të paobservueshme reflektojnë diferencat midis instrumentave.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë modelet e vlerës aktuale neto dhe te flukseve të skontuara të parasë, krahasimin me instrumenta të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime tregu të observueshme dhe bazuar në një kurbë të përshatshme të normës korrente të interesit për kohën e mbetur deri në maturim. Supozimet dhe inputet e përdorura në teknikat e vlerësimit marrin parasysh normat me risk zero dhe normat bazë të interesit, spread-et e kredisë dhe prime të tjera të përdorura në vlerësimin e normave të skontos, çmimet e obligacioneve dhe të kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, kapitalin dhe çmimet e indeksuara të kapitalit dhe luhatjet apo korrelimet e pritura të çmimeve. Objektivi i teknikave të vlerësimit është që të arrihet të përcaktohet vlera e drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, vlerë e cila do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrësit e tregut në kushtet e një transaksioni të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra tjetrën.

(iv) Përllogaritja e tatimit mbi fitimin e korporatës

Menaxhimi beson se llogaritja e tatimit mbi provigjionin e fitimit është e përshtatshme duke marrë parasysh pasigurinë e mjedisit ligjor shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi dhe çdo auditim tatimor i ardhshëm nuk do të ketë një efekt domethënës në pozicionin financiar të Shoqërisë, në rezultatet e operacioneve apo në flukset e parasë. Sidoqoftë, bazuar dhe në natyrën e ligjit për tatim fitimin, praktikën e lidhura dhe udhëzimet nuk është e mundur të përcaktohet me saktësi që pozicioni ligjor i tatimit aktual do të qëndrojë i pakundërshtueshëm nga autoritetet tatimore.

5. Menaxhimi i Rrezikut Financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të riskut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e riskut. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (risku i monedhës, risku i normave të interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i një impakti financiar negativ si rrjedhojë e ndryshimeve të tregut të tilla si ndryshimet në kurset e këmbimit, në normat e interesit dhe ndryshime të tjera në çmime. Risqet e tregut krijohen për shkak të luhatjeve si në vlerën e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve të mbajtura. Shoqëria ka përcaktuar politika dhe procedura për menaxhimin e riskut të tregut.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përkthimit të tij në monedhën lokale. Risku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet. Normat zyrtare sipas Bankës Qendrore (Lek për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 ishin si më poshtë:

:

	31 dhjetor 2014		31 dhjetor 2013	
	Mesatare	Në mbyllje	Mesatare	Në mbyllje
Dollari Amerikan (USD)	105.48	115.23	105.67	101.86
Njësia e monedhës së BE (EUR)	139.97	140.14	140.26	140.20

Aktivët dhe detyrimet e shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

(Të përkthyer në Lek)	Në Lek	Në EUR	Në USD	Në CHF	Totali
Aktivët					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	7,003,888	4,763,951	113,035	95,224	11,976,098
Depozita me afat në bank	277,006,688	198,992,576	47,720,241	-	523,719,505
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	62,206,857	30,894,920	2,933,442	-	96,035,219
Aktive të risiguruesve	8,642	13,325,863	-	-	13,334,505
Totali i aktiveve financiare	346,226,075	247,977,310	50,766,718	95,224	645,065,327
Detyrimet					
Provigjone per deme	129,227,511	19,442,841	-	-	148,670,352
Provigjone të kontratave të sigurimit	303,360,101	31,681,039	503,227	-	335,544,367
Te pagueshme ndaj risiguruesi	-	27,020,152	-	-	27,020,152
Detyrime sigurimi dhe te tjera	127,207,795	20,456,300	-	-	147,664,095
Totali i detyrimeve financiare	559,795,407	98,600,332	503,227	-	658,898,966
Pozicioni neto në monedhë të huaj	(213,569,332)	149,376,978	50,263,491	95,224	(13,833,639)

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Aktivët dhe detyrimet e Shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2013 paraqiten si më poshtë:

(Të përkthyer në Lek)	Në Lek	Në EUR	Në USD	Në CHF	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	3,900,513	2,894,314	110,455	106,772	7,012,054
Depozita me afat në bank	261,473,283	190,456,895	42,183,318	-	494,113,496
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	82,385,320	40,916,516	3,884,983	-	127,186,819
Aktive të risiguruesve	-	7,203,535	-	-	7,203,535
Totali i aktiveve financiare	347,759,116	241,471,260	46,178,756	106,772	635,515,904
Detyrimet					
Provigjone për deme	137,766,099	44,629,842	-	-	182,395,941
Provigjione të kontratave të sigurimit	183,620,481	34,674,123	1,029,121	-	219,323,725
Te pagueshme ndaj risiguruesi	-	26,561,303	-	-	26,561,303
Detrime sigurimi dhe të tjera	180,749,584	30,576,000	318,102	-	211,643,686
Totali i detyrimeve financiare	502,136,164	136,441,268	1,347,223	-	639,924,655
Pozicioni neto në monedhë të huaj	(154,377,048)	105,029,992	44,831,533	106,772	(4,408,751)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**Risku i normës së interesit**

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti financiar.

Analiza e sensitivitetit

Tabela e mëposhtme detajon sensitivitetin e Shoqërisë ndaj rritjes dhe uljes së Lekut përkundrejt monedhave të tjera relevante. Ky ndryshim në kurset e këmbimit përdoret kur bëhen raportimet e brendshme të riskut nga kurset e këmbimit për personelin e lartë menaxherial dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhimit mbi ndryshimet e mundshme të kurseve të këmbimit valutor. Më poshtë paraqitet ndikimi i ndryshimit të një faktori të vetëm, ndërsa faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, në analizën e sensitivitetit. Analiza e sensitivitetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	Ndikimi	Shuma
EUR rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	14,937,698
EUR bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(14,937,698)
USD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	5,026,349
USD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(5,026,349)

Analiza e sensitivitetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013:

	Ndikimi	Shuma
EUR rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	10,502,999
EUR bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(10,502,999)
USD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	4,483,153
USD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(4,483,153)

Risku i kredisë

Risku i kredisë i referohet riskut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpasitë të risigurimit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB- ose më të larta sipas S&P ose Moody dhe monitorohen nga personeli i departamentit të risigurimeve. Shoqëria menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kundërpasitë të depozitave me afat.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Shoqëria menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt duke monitoruar vazhdimisht të arkëtueshmet nga sigurimet. Këto të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 sipas vjetërsisë paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	%
1 deri 3 muaj	11,531,648	12%
3 muaj deri 1 vit	45,006,216	47%
Me shume se 1 vit	39,497,355	41%
Totali	96,035,219	100%
	31 dhjetor 2013	%
1 deri 3 muaj	8,693,287	7%
3 muaj deri 1 vit	9,975,582	8%
Me shume se 1 vit	108,517,950	85%
Totali	127,186,819	100%

F Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 vlerësimi për riskun e kredisë nga primet e ceduara të risigurimit dhe aktivet e risigurimit bazuar në vlerësimin e risiguresve është si më poshtë:

	2014				2013			
	Prime të ceduara		Aktive të risigurimit		Prime të ceduara		Aktive të risigurimit	
	'000	% e	'000	% e	'000	% e	'000	% e
	Lek	totalit	Lek	totalit	Lek	totalit	Lek	totalit
Vlerësimi								
AA	-	-	-	-	-	-	-	-
AA-	-	-	-	-	-	-	-	-
A+	13,791,382	81%	7,483,660	56%	3,480,481	9%	656,022	9%
A	-	-	-	-	24,689,436	63%	4,264,829	59%
A-	3,282,318	19%	5,850,845	44%	11,207,111	28%	2,282,684	32%
BBB	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	17,073,700	100%	13,334,505	100%	39,377,028	100%	7,203,535	100%

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**Risku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkalluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Shoqëria ka akses në huamarrje më 31 dhjetor 2014 dhe 2013. Shoqëria menaxhon riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Aktivitet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 të detajuara sipas maturitetit paraqiten më poshtë.

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Midis 1 vit dhe 5 vjet	Totali
Aktivitet				
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11,976,098	-	-	11,976,098
Depozita me afat në bank	2,611,239	369,539,969	151,568,297	523,719,505
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	24,008,804	72,026,415	-	96,035,219
Aktive të risiguruesve	-	13,334,505	-	13,334,505
Totali i aktiveve financiare	38,596,141	454,900,889	151,568,297	645,065,327
Detyrimet				
Provigjone per deme	27,725,509	83,176,527	37,768,316	148,670,352
Provigjone të kontratave të sigurimit	17,498,869	306,006,288	12,039,210	335,544,367
Te pagueshme ndaj risiguruesi	27,020,152	-	-	27,020,152
Detyrime sigurimi dhe te tjera	102,736,907	44,927,188	-	147,664,095
Totali i detyrimeve financiare	174,981,437	434,110,003	49,807,526	658,898,966
Pozicioni i likuiditetit neto	(136,385,296)	20,790,886	101,760,771	(13,833,639)
Hendeku kumulativ	(136,385,296)	(115,594,410)	(13,833,639)	-

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013 kanë maturitetet e mëposhtme:

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Midis 1 vit dhe 5 vjet	Totali
Aktivitet				
Mjete monetare dhe ekuivalentë	7,012,054	-	-	7,012,054
Depozita me afat në bank	2,664,024	301,970,319	189,479,153	494,113,496
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	31,796,705	95,390,114	-	127,186,819
Aktive të risiguruesve	-	7,203,535	-	7,203,535
Totali i aktiveve financiare	41,472,783	404,563,968	189,479,153	635,515,904
Detyrimet				
Provigjone për deme	36,667,759	110,003,277	35,724,905	182,395,941
Provigjone të kontratave të sigurimit	11,437,883	200,016,587	7,869,255	219,323,725
Te pagueshme ndaj risiguruesi	26,561,303	-	-	26,561,303
Detyrime sigurimi dhe të tjera	141,698,400	69,945,286	-	211,643,686
Totali i detyrimeve financiare	216,365,345	379,965,150	43,594,160	639,924,655
Pozicioni i likuiditetit neto	(174,892,562)	24,598,818	145,884,993	(4,408,751)
Hendeku kumulativ	(174,892,562)	(150,293,744)	(4,408,751)	-

Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Struktura e kapitalit të Shoqërisë konsiston në kapital që i atribuohet mbajtësve të kapitalit të Shoqërisë, dhe përfshin kapitalin e paguar, rezervat dhe fitimin e mbajtur. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar që çdo vendndodhje të mbajë nivelet e kërkuara të kapitalit që siguron vijimësinë e aktivitetit dhe përputhshmërinë me kërkesat për kapital të rregullatorëve, ndërsa maksimizon kthimin ndaj aksionerëve përmes optimizimit të raportit të borxhit me kapitalin.

Më 31 dhjetor 2014 aktive për mbulimin të provigjoneve teknike dhe matematike ishin vetëm 76% të provigjoneve teknike bruto, kundrejt minimumit të kerkuar prej 100% nga ligji i sigurimit. Drejtimi parashikon se rezultatet e vazhdueshme dhe veprimet e duhura të aksionerit, duke përfshirë dhe transferimin e investimeve në ndertesa në mjete me likuide duhet të ndihmojë në arritjen e kufirit minimal të kerkuar nga rregullatori

Rreziqe të tjera

Ndryshimet në rregulloret shtetërore për segmentet e biznesit në të cilat Shoqëria operon mund të prekin përfitueshmërinë e saj. Biznesi i sigurimeve është subjekt i mbikqyrjeve gjithëpërfshirëse dhe zhvilluese. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policëmbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën Shoqëria drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi i herë pas hershëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat korrente.

5. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria merr mbi vete rrezik të sigurimit përmes kontratave të sigurimit në të cilat merr parasysh rrezikun e humbjes nga personat apo organizatat që janë drejtpërdrejt subjekt i humbjes. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë që ka të bëjë me kohën, frekuencën dhe shkallën e dëmeve të lidhura me këto kontrata.

Shoqëria menaxhon rrezikun përmes strategjisë së risigurimit dhe të marrjes në sigurim brenda kontureve të një menaxhimi risku të përgjithshëm. Vendorsja e çmimeve bëhet bazuar në trendet dhe përvojat e kaluara. Ekspozimi menaxhohet duke pasur të dokumentuar limitet dhe kriteret e marrjes në sigurim. Risigurimet realizohen për t'i lehtësuar Shoqërisë efektin e humbjeve të mundshme nga ngjarjet individuale të mëdha apo katastrofave si dhe për të siguruar akses te specialistë të riskut dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit shkruhen me risigures të aprovuar ose mbi bazën e një marrëveshje proporcionale ose mbi bazën e një marrëveshje të tejkalimit të humbjes.

Kapitali rregullator menaxhohet gjithashtu (edhe pse jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar.

Shoqëria shkruan polica për prona, detyrime dhe mjete motorrike kryesisht për kohëzgjatje mbi 12 muaj. Rreziqet më të rëndësishme vijnë prej katastrofave natyrore, ndryshimeve klimatike dhe katastrofave të tjera (ngjarje me frekuencë të ulët dhe shkallë dëmi të lartë). Rrezik i koncentruar vjen edhe prej një kontrate të vetme që i lëshohet policëmbajtësve të një tipi demografie të veçantë, brenda një zone gjeografike të caktuar ose tipeve të bizneseve tregtare. Ndryshueshmëria e rezultatit lehtësohet nëse portofoli përbëhet nga shumë rreziqe të ngjashme.

Më poshtë jepet një përmbledhje e koncentrimin të provigjioneve për dëme sipas tipit të kontratës duke iu referuar detyrimeve të sigurimit:

	2014			2013		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Linja e biznesit						
Mjete						
motorrike	145,155,681	(5,850,845)	139,304,836	176,136,112	(2,385,534)	173,750,578
Prona	1,410,873	-	1,410,873	5,707,927	-	5,707,927
Shëndeti						
dhe						
aksidentet	2,103,798	-	2,103,798	551,902	-	551,902
Totali	148,670,352	(5,850,845)	142,819,507	182,395,941	(2,385,534)	180,010,407

Më poshtë jepet një përmbledhje e koncentrimin të primeve sipas tipit të kontratës duke iu referuar detyrimeve të sigurimit:

	2014			2013		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Linja e biznesit						
Mjete						
motorrike	553,985,558	(3,282,318)	550,703,240	299,320,663	(17,957,078)	281,363,585
Prona	113,798,284	(13,791,382)	100,006,902	61,641,228	(21,419,950)	40,221,278
Shëndeti						
dhe						
aksidentet	21,839,239	-	21,839,239	24,268,885	-	24,268,885
Totali	689,623,081	(17,073,700)	672,549,381	385,230,776	(39,377,028)	345,853,748

5. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)***Dëmet aktuale të krahasuara me vlerësimet***

Tabela e mëposhtme tregon dëmet aktuale të ndodhura të krahasuara me vlerësimet e mëparshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	2014	2013
RBNS		
Vlerësimet fillestare për dëmet	145,671,036	205,760,808
Rezultatet aktuale në lidhje me dëmet e ngjara	(82,109,729)	(122,210,711)
Vlerësimet përfundimtare për dëmet	(58,616,628)	(40,937,218)
Shmangia në Lek ‘000	4,944,679	42,612,879
Shmangia në %	3.39%	20.71%
IBNR		
Vlerësimet fillestare për dëmet	35,724,905	22,528,323
Rezultatet aktuale në lidhje me dëmet e ngjara	(18,926,762)	(17,707,011)
Vlerësimet përfundimtare për dëmet	(5,593,900)	(3,338,720)
Shmangia në Lek ‘000	11,204,243	1,482,592
Shmangia në %	31.36%	6.58%

Menaxhimi rishikon vlerësimin për dëmet dhe supozimet duke u bazuar në zhvillimet e dëmeve aktuale dhe bën rregullimet e duhura në metodologjinë e vlerësimit të dëmeve. Në vitin aktual, ka pasur një besim më të madh ndaj metodologjive aktuariale të tilla si trekëndëshi i dëmeve.

Procesimi i dëmeve

Dëmet e ndodhura procesohen përgjithësisht brenda një periudhe të shkurtër kohe dhe mbyllen zakonisht brenda një viti. Dëmet nga Kartonat Jeshil kanë një periudhë shlyerje më të gjatë e megjithatë jo shumë më të gjatë sesa mbi një vit. Nga përvoja e Shoqërisë, procesimi i dëmeve nuk ndryshon në mënyrë materiale nga vlerësimet paraprake.

5. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)**Supozime dhe sensitiviteti**

Reziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kuantitative të sensitivitetit. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë treguesë të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Shoqëria e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihen në pasqyrat e vecanta të pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Një pamje e përgjithshme e humbjeve nga dëmet dhe raportit të kombinuar për vitin 2014 dhe 2013 jepet më poshtë:

	2014	2013
Raporti i dëmeve	43%	65%
Raporti i shpenzimeve	67%	88%
Raporti i kombinuar	110%	153%

Rezultatet e analizës së sensitivitetit që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj sensitiviteti tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara.

	Impakti	2014	2013
Raporti i dëmeve			
5% rritje në raportin e dëmeve	humbje	12,021,725	13,197,077
5% rënie në raportin e dëmeve	fitim	(12,021,725)	(13,197,077)
Raporti i shpenzimeve			
5% rritje në raportin e shpenzimeve	humbje	18,832,461	18,006,297
5% rënie në raportin e shpenzimeve	fitim	(18,832,461)	(18,006,297)
Raporti i kombinuar			
5% rritje në raportin e kombinuar	humbje	30,854,186	31,203,374
5% rënie në raportin e kombinuar	fitim	(30,854,186)	(31,203,374)

6. Shënime shpjeguese për përcaktimin e vlerës së drejtë

Politikat kontabël të Shoqërisë dhe shënimet shpjeguese kërkojnë që të përcaktohet vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Vlera e drejtë përcaktohet për qëllime të shënimeve shpjeguese bazuar në metodat e mëposhtme. Aty ku duhet, jepen sqarime të mëtejshme lidhur me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë si më poshtë:

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe Depozita me afat me bankat- të cilat përfshijnë paranë në banka dhe depozitat me afat, përfshijnë vendosjet ndërbankare dhe zëra në proces mbledhjeje. Duke qënë se depozitat janë afatshkurtra dhe me norma të luhatshme, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e afërt me vlerën e tyre kontabël.

Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme - Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme, është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre.

	Hua dhe të arkëtueshme	Të mbajtura deri në maturim	Te tjera me kosto te amortizuar	Vlera kontabël totale	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2014					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11,976,098	-	-	11,976,098	11,976,098
Depozita me afat me bankat	523,719,505	-	-	523,719,505	523,719,505
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme	96,035,219		-	96,035,219	96,035,219
31 dhjetor 2013					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	7,012,054	-	-	7,012,054	7,012,054
Depozita me afat me bankat	494,113,496	-	-	494,113,496	494,113,496
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme	127,186,819		-	127,186,819	127,186,819

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***7. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare**

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Para në dorë	645,442	524,132
<i>Llogari rrjedhëse</i>	<i>11,330,656</i>	<i>6,487,922</i>
Para në bankë në Lek	6,383,466	3,428,341
Para në bankë në EUR	4,738,521	2,842,414
Para në bankë në USD	113,445	110,395
Para në bankë në CHF	95,224	106,772
Total	11,976,098	7,012,054

8. Depozita me afat me bankat

Depozitat me afat me bankat më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Depozita bankare	29,499,660	98,140,000
Interes i perllogaritur nga depozitat	4,412,925	9,959,102
Fondi i garancisë	489,806,920	386,014,394
Totali i depozitave dhe fondit të garancisë	523,719,505	494,113,496

Fondi i garancisë përbëhet nga depozitat bankare të bllokuara pranë bankave tregtare të Republikës së Shqipërisë. Fondi i garancisë mund të investohet vetëm përmes sistemit bankar në depozita me afat ose bono thesari dhe nuk është disponibël për operacione të përditshme.

Në përputhje me Nenin 81 të Ligjit për Sigurimet, përsa i përket fondit të garancisë, Shoqëria mban një minimum prej 1/3 të nivelit të kërkuar të marzhit të aftësisë paguese por jo më pak se 370 milion Lek, në bono thesari dhe depozita me afat me maturitet prej jo më pak se 1 vit.

9. Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme

Të arkëtueshmet nga sigurimet përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Të arkëtueshme nga policëmbajtësit	94,709,361	127,186,819
Të arkëtueshme nga Shoqëritë e sigurimit	1,325,858	-
Totali	96,035,219	127,186,819

Të arkëtueshmet nga policëmbajtësit bruto dhe neto nga zbritja e të arkëtueshmeve të dyshimta paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Të arkëtueshmet nga sigurimet, bruto	127,734,110	158,885,710
Minus: Zbritja për humbjet nga zhvlerësimet	(31,698,891)	(31,698,891)
Të arkëtueshme nga sigurimet, neto	96,035,219	127,186,819

Lëvizjet në zbritjet për humbje nga zhvlerësimet detajohen si më poshtë:

	2014	2013
Balanca e hapjes	31,698,891	83,955,350
Zhvlerësimi për vitin	-	6,978,381
Fshirje	-	(59,234,840)
Balanca e mbylljes	31,698,891	31,698,891

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***10. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim**

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Komisionet e agjentëve dhe kosto të tjera	95,813,526	63,278,927
Totali	95,813,526	63,278,927

11. Aktive të risigurimit

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Pjesa e risiguruesve në primin e pafituar	7,483,660	4,818,001
Pjesa e risiguruesve në dëmet e raportuara	5,850,845	2,385,534
Totali	13,334,505	7,203,535

12. Investime ne ndertesa

	Ndertesa
Kosto	
Balanca me 1 janar 2013	516,926,363
Shtesa	-
Balanca me 31 Dhjetor 2013	516,926,363
Shtesa	20,000,000
Nxjerrje jashte perdorimit	(18,768,816)
Balanca me 31 Dhjetor 2014	518,157,547
Amortizimi i akumuluar	
Balanca me 1 janar 2013	(47,981,616)
Amortizimi i vitit	(23,447,239)
Balanca me 1 janar 2013	(71,428,855)
Amortizimi i vitit	(22,770,121)
Nxjerrje jashte perdorimit	5,536,114
Balanca me 31 Dhjetor 2014	(88,662,862)
Vlera kontabël neto	
Më 1 janar 2013	468,944,747
Më 1 janar 2014	445,497,508
Më 31 dhjetor 2014	429,494,685

Investime ne ndertesa perfshin ndertesat e blera bazuar ne vendimin e aksionerit te vetem me besimin se vlera e tyre do te rritet ne te ardhmen. Me 31 dhjetor 2014 Shoqeria nuk ka pergatitur raporte vleresimi, megjithate drejtimi beson se vlera e drejte e ketyre pronave nuk eshte me e ulet se vlera kontabel neto.

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***13. Prona dhe pajisje**

Lëvizjet gjatë 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	Kioska	Kompjuter	Mjete motorrike	Mobilje dhe pajisje zyre	Totali
Kosto					
Më 1 janar 2013	13,416,673	48,690,837	29,351,656	44,740,485	136,199,651
Shtesa	-	179,201	-	333,065	512,266
Më 31 dhjetor 2013	13,416,673	48,870,038	29,351,656	45,073,550	136,711,917
Shtesa	-	636,355	-	125,000	761,355
Më 31 dhjetor 2014	13,416,673	49,506,393	29,351,656	45,198,550	137,473,272
Amortizimi i akumuluar					
Më 1 janar 2013	(10,264,933)	(35,583,242)	(19,273,416)	(33,517,941)	(98,639,532)
Shpenzime të vitit	(628,648)	(3,324,501)	(2,015,648)	(2,283,638)	(8,252,435)
Më 31 dhjetor 2013	(10,893,581)	(38,907,743)	(21,289,064)	(35,801,579)	(106,891,967)
Shpenzime të vitit	(502,919)	(2,570,174)	(1,612,519)	(1,854,869)	(6,540,480)
Më 31 dhjetor 2014	(11,396,500)	(41,477,917)	(22,901,583)	(37,656,448)	(113,432,447)
Vlera kontabël neto					
Më 1 janar 2013	3,151,740	13,107,595	10,078,240	11,222,544	37,560,119
Më 1 janar 2014	2,523,092	9,962,295	8,062,592	9,271,971	29,819,950
Më 31 dhjetor 2014	2,020,173	8,028,476	6,450,073	7,542,102	24,040,825

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***14. Intangible assets**

Movements during 2014 and 2013 are as follows

	Program kompjuterik
Kosto	
Më 1 janar 2013	6,231,578
Shtesa	768,600
Më 31 dhjetor 2013	7,000,178
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2014	7,000,178
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2013	(3,596,108)
Shpenzime të vitit	(835,076)
Më 31 dhjetor 2013	(4,431,184)
Shpenzime të vitit	(625,914)
Më 31 dhjetor 2014	(5,057,098)
Vlera kontabël neto	
Më 1 janar 2013	2,635,470
Më 1 janar 2014	2,568,994
Më 31 dhjetor 2014	1,943,080

15. Aktive te tjera

Aktivet e tjera me 31 dhjetor 2014 dhe 2013 perbehen si meposhte:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Inventare	26,651,990	31,723,895
Paradhenie personeli	25,810,479	19,843,489
Të tjera	49,762,137	43,718,552
Totali	102,224,606	95,285,936

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***16. Detyrimet për humbjet dhe rregullimet e humbjeve**

	2014	2013
Gjendja më 1 Janar	182,395,941	228,263,108
Detyrime bruto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve		
Rimarrje nga risigurimet	(2,385,534)	(74,525,563)
Detyrime neto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	180,010,407	153,737,545
Dëme të ndodhura	240,434,500	263,941,534
Dëme të paguara	(277,625,400)	(237,668,672)
Me 31 Dhjetor		
Detyrime neto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	142,819,507	180,010,407
Rimarrje nga risigurimet	5,850,845	2,385,534
Detyrime bruto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve në fund të vitit	148,670,352	182,395,941

Ndryshimi bruto në rezervat e sigurimit të dëmeve përbëhet nga ndryshimi bruto në rezervat për dëmet e raportuara por ende të pashlyera dhe në dëmet e ngjara por ende të paraportuara. Rezervat për detyrimet dhe humbjet e sigurimit për 2014 janë aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me 20 mars 2015.

Dëmet e paguara sipas produkteve të sigurimit paraqiten si më poshtë:

	2014	2013
Mjete motorrike	275,356,382	254,739,344
Prona	3,786,027	2,456,910
Shëndeti	1,936,703	248,927
Deme te paguaranga risiguruesi	(3,453,712)	(19,776,509)
Totali	277,625,400	237,668,672

17. Rezerva për primet e pafituara

	2014	2013
Gjendja më 1 Janar	219,323,725	282,180,609
Prime të shkruara gjatë vitit (shiko shënimin 24)	689,623,081	385,230,776
Minus: Prime të fituara gjatë vitit	(573,402,439)	(448,087,660)
Gjendja më 31 dhjetor	335,544,367	219,323,725

	2014	2013
Ndryshimi bruto ne rezerven e primit te pafituar	(116,220,642)	62,856,883
Ndryshimi ne pjesen e risiguruesve	2,665,659	(719,706)
Gjendja më 31 dhjetor	(113,554,983)	62,137,177

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***18. Detyrime ndaj risigureseve**

Detyrime ndaj risigureseve me 31 dhjetor 2014 dhe 2013 perbehet si meposhte:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Mjete motorrike	27,020,152	26,561,303
Totali	27,020,152	26,561,303

19. Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera

Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera perbehet si meposhte:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Rezerva per fondin e kompensimit	-	19,682,087
Të pagueshme furnitore	32,627,858	54,461,568
Të pagueshme ndaj shtetit	92,030,359	106,753,544
Tarifa te pagueshme	7,437,662	8,182,389
Te pagushem ndaj personelit	3,651,833	6,908,217
Të pagueshme të tjera	11,916,383	15,655,881
Totali	147,664,095	211,643,686

20. Tatim fitimi i pagueshem

Shoqëria më 31 dhjetor 2014 ka detyrim per tatim fitimin prej 14,945,344 Lek (2013: 14,945,344 Lek)

21. Te pagueshme ndaj aksionerit

Te pagueshme ndaj aksionerit perbehet si meposhte:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Parapagime nga aksioneri	-	98,378,000
Detyrime te tjera	-	5,075,655
Totali	-	103,453,655

22. Kapitali aksioner

Kapitali aksionar i Shoqërisë është i shprehur në Lek. Kapitali aksionar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2014 është 756,108,491 (2013: 657,730,491 Lek), i përbërë nga 75,610 aksione të zakonshme (2013: 65,773 (2013: 65,773 aksione të zakonshme) me vlerë nominale prej 10,000.11 Lek (2013: Lek 10,000.01). Gjatë 2014, aksionari konvertoi detyrimet ndaj tij për 98,378,000 Lek si një kontribut ndaj kapitalit aksionar. Levizja e kapitalit me 31 dhjetor 2014 dhe 2013 eshte paraqitur si meposhte:

	31 dhjetor 2014		31 dhjetor 2014	
	Numri i aksioneve	Lek	Numri i aksioneve	Lek
Kapitali aksionar me 1 Januar	65,773	657,730,491	62,834	628,336,081
Rritja e kapitalit nepermjet kontributit ne para	-	-	2,939	29,394,410
Kontribut i aksionarit nepermjet konvertimit te detyrimit	9,837	98,378,000	-	-
Kapitali aksionar me 31 dhjetor	75,610	756,108,491	65,773	657,730,491

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***23. Rezervat e riskut të sigurimit**

Rezerva e riskut të sigurimit krijohet bazuar në kerkesat e Ligjit për Sigurimet dhe është e barabartë me një të tretën e fitimeve të periudhës së mëparshme nëse fitimet nuk përdoren për të mbuluar humbje të akumuluar të trashëguara prej viteve të mëparshme. Kjo rezervë nuk rritet më tepër se 30% e primeve mesatare të arkëtuara në dy vitet e fundit. Kjo rezervë krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë.

24. Primet e shkruara bruto

Primet e shkruara bruto të sigurimit sipas produkteve detajohen si mëposhtë:

	2014	2013
Mjete motorrike	552,944,516	299,320,661
Prona	113,617,462	61,641,228
Shëndeti	23,061,103	24,268,887
Totali	689,623,081	385,230,776

25. Prime të ceduara te risiguruesit

Primet e ceduara të risiguruesit sipas produkteve të sigurimit detajohen si mëposhtë:

	2014	2013
Mjete motorrike	3,282,318	17,957,078
Prona	13,791,382	21,419,950
Totali	17,073,700	39,377,028

26. Te ardhura te tjera

	2014	2013
Te ardhura nga komisionet	31,283,836	201,226
Te ardhura nga shitje e investimeve ne ndertesa	17,780,000	-
Te tjera	4,733,345	4,808,427
Total	53,797,181	5,009,653

27. Shpenzime të marrjes në sigurim

	2014	2013
Komisione	140,790,426	81,968,516
Paga per shitjen	30,358,135	29,267,801
Shpenzime te tjera te marrjes ne sigurim	30,826,924	7,339,101
Totali	201,975,485	118,575,418

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***28. Shpenzime administrimi**

	2014	2013
Kontributi per fondin e kompensimit	36,641,734	46,412,419
Kosto personeli	34,371,040	45,647,660
Qera	34,671,910	38,552,742
Shpenzime amortizimi	29,936,516	32,534,752
Shpenzime reklamimi	-	12,703,302
Shpenzime per borxhin e keq	-	6,978,381
Sherbime nga pale te treta	5,644,320	5,172,895
Shpenzime taksa	3,895,863	2,589,649
Shpenzime mirembajtjeje	3,828,823	4,272,762
Shpenzime te tjera	49,606,423	23,257,860
Totali	198,596,629	218,122,422

29. Shpenzime te tjera ne lidhje me sigurimet

Shpenzimet e tjera ne lidhje me sigurimet per vitin e mbyllur 31 dhjetor 2014 dhe 2013 jane detajuar si meposhte:

	2014	2013
Shpenzime per autoritetin	-	3,985,924
Kontribut per Byrone e Sigurimeve	6,195,483	5,877,732
Kontribut per Shoqaten e Sigurimeve	2,416,216	475,564
Totali	8,611,699	10,339,220

30. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 and 2013 u fituan nga aktivet e meposhtëme:

	2014	2013
Interesi nga depozitat	11,558,628	20,445,521
Interesi nga llogaritë rrjedhëse dhe të tjera	24,089	7,203
Totali	11,582,717	20,452,724

31. Fitime/(humbja) nga kursi i këmbimit, neto

	2014	2013
Fitime nga kursi i këmbimit, bruto	8,113,095	5,074,890
Humbje nga kursi i këmbimit, bruto	(573,734)	(6,138,207)
Totali	7,539,361	(1,063,317)

*(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***32. Tatim fitimi**

Tatim fitimi në Shqipëri është në normën 15% (2013: 10%) e të ardhurave të taksueshme. Më poshtë paraqitet një rikoncilim i llogaritjes së tatim fitimit me normën tatimore të aplikueshme për shpenzimin e tatim fitimit:

	2014		2013	
Humbja e vitit përpara tatim fitimit		14,108,279		(194,762,661)
Tatimi i llogaritur me 15 % (2013: 10%)	15%	2,116,242	10%	(19,476,266)
Efekti ne tatim i shpenzime te pazbritshme	12%	1,629,636	(1%)	1,009,003
Efekti tatimor i humjeve te mbartura i panjohur	-	-	(9%)	18,467,263
Njohja e efektit tatimor per humbjet e mbartura te panjohura me pare	27%	(3,745,878)	-	-
Shpenzimet nga tatim fitimit		-		-

33. Angazhime dhe detyrime rastësore

Përgjatë rrjedhes të zakonshëm të biznesit, Shoqëria është përfshirë në pretendime dhe veprime ligjore të ndryshme. Sipas opinionit të menaxhimit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë efekt negativ material në pozicionin financiar të Shoqërisë apo ndryshimin e aktiveve neto. Çështjet ligjore janë të zakonshme në të cilat paditësit nuk bien dakord me vlerësimin e dëmit të bërë nga Shoqëria. Menaxhimi i vlerëson pretendimet duke përdorur ekspertizë të jashtme dhe të brendshme përfshirë këtu edhe konsulencën ligjore. Menaxhimi beson se këto vlerësime janë të përshtatshme por megjithatë pranon se rezultati final mund të jetë një shumë më e madhe ose më e vogël sesa ajo e parashikuar. Më 31 Dhjetor 2014 kishte 31 raste ende në proces për të cilat kërkesat e klientëve në mënyrë të agreguar ishin 1,500 mije Lek më shumë sesa shuma e parashikuar nga Shoqëria (2013: bazuar ne opinionin e perfaqesuesit ligjor nuk ka patur ceshtje gjyqesore, e cila do kerkonte njohjen e nje provigjioni shtese ne pasqyrat financiare sipas kerkesave te kuadrit raportues).

Fondi Kompesimit per MPTL

Shoqëritë e Sigurimit të cilat ofrojnë sigurimin e detyrueshëm për mjetet motorrike në Shqipëri janë të detyruara të kontribuojnë pranë autoriteteve përkatëse fondin e kompesimit të sigurimit në baze vjetore në përpjestim të tregut të MTPL-së që ato kanë patur përgjatë viteve përkatëse. Shuma dhe koha e pagesave e fondit të kompesimit aprovet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (“AMF”) në vijim të propozimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Vendimi i AMF-së publikohet gjatë tre mujorit të parë të vitit dhe i komunikohet Shoqërive të Sigurimit në lidhje me kohën dhe shumën e pagesave të vitit aktual. Deri më sot Shoqëria ka shlyer dhe njohur detyrimet në lidhje me pagesat për 2014. Në vlerësimin e shumave për tu njohur dhe kur duhet të njihen, Drejtimi ka marrë parasysh KIRFN 21, ku ngjarja detyruese e cila ndikon në njohjen e një detyrimi për të paguar një detyrim ligjor është aktiviteti që shkakton pagesën e detyrimit dhe kjo është vendimi i AMF-së me datë 28 Shkurt 2014. Ndërkohë, më 20 Mars 2015, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare raportoi fondin e kompesimit për 2015 për të gjithë tregun e sigurimeve që ishte 450 Milion Lek për dëmet e vjetra dhe 20 Milion Lek për dëmet e reja pa marrë në konsideratë propozimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Sipas propozimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit fondi i kompesimit për vitin 2015 është shumë më pak se sa kërkuar nga AMFja dhe për rrjedhojë, ka një devijim domethënës nga shuma e fondit të kompesimit të propozuar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit për 2015. Ky devijim është rezultati i një auditimi të kryer nga Asambleja e Përgjithshme e Byrosë Shqiptare të Sigurimit përfundimi i të cili rezultoi në pasaktësi të ndryshme në vlerësimin e detyrimeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit kundrejt palëve të treta. Më 20 Maj 2015, Byroja Shqiptare e Sigurimit raportoi pjesën e fondit të kompensimit për secilën nga shoqëritë e sigurimit e cila paraqiste një detyrim ligjor të Shoqërisë prej Lek 41 milion për dëmet e vjetra dhe Lek 1.8 milion për dëmet e reja, e shoqëruar nga një letër e datës 29 Maj 2015 nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare Shqiptare duke i kërkuar Shoqërisë njohjen e një provigjioni respektiv në këto pasqyra financiare të konsoliduara për pjesën e fondit të kompensimit për dëmet e vjetra, për 2015 dhe 2016. Gjithsesi, Grupi e ka konsideruar letrën respektive jo ligjërish të detyrueshme dhe për më tej ka vlerësuar se ka një pasiguri të konsiderueshme për shumën që duhet të paguhet për dëmet e vjetra të fondit të kompensimit për 2015 dhe 2016. Për këto arsye ka një paqartësi të konsiderueshme në lidhje me shumën e fondit të kompesimit propozuar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit për 2015. Drejtimi përcaktoi shumën e detyrimit duke marrë parasysh kuadrin ligjor në fuqi dhe në datën e këtij raportimi Grupi nuk ka njohur ndonjë provigjion shtesë në pasqyrat financiare bashkëngjitur.

Atlantik Sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***33. Angazhime dhe detyrime rastësore (vazhdim)****Angazhimet e qerasë operative**

Me 31 dhjetor 2014 dhe 2013, Shoqëria ka hyrë në disa angazhime qiraje në lidhje me përdorimin e zyrave të cilat kanë data të ndryshme maturimi. Angazhmimi minimal i shoqërisë në lidhje me këto kontrata është si mëposhte:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Jo më vonë se 1 vit	8,954,179	8,956,227
	8,954,179	8,956,227

Detyrime të tjera rastësore

Ndryshimet e rregulloreve shtetërore për segmentet e biznesit në të cilat Shoqëria operon.

Biznesi i sigurimeve është subjekt i mbikqyrjes në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policëmbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën Shoqëria drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi herë pas herëshëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat korrente.

34. Shënime shpjeguese për palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie të palëve të lidhura me shoqëri të cilat janë nën kontrollin e saj dhe nën kontroll të përbashkët të aksionerit të vetëm Dritan Celaj. Shoqëria ka gjithashtu marrëdhënie të palëve të lidhura me drejtorët dhe drejtuesit ekzekutivë. Përgjatë vitit janë kryer transaksione me palët e lidhura si vijon:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
<i>Të ardhura</i>		
Primi të nenshtruara për Riviera Shpk	3,549,021	1,588,745
Primi të nenshtruara për Z. Dritan Celaj	29,250	-
Shitje e investimit në ndertesa të Z. Dritan Celaj	17,780,000	-
<i>Shpenzime</i>		
Shpenzime të tjera me Riviera shpk	-	(19,740,093)
Shpenzime qiraje	(15,471,600)	(18,336,000)
Shpenzime sigurie - Aulona Pol 1 shpk	(1,548,000)	(1,548,000)
SHpenzime hoteli - Hotel Riviera	-	(38,000)
Kompensimi i Menaxhimit	(6,120,000)	(6,000,000)
	31 December 2014	31 December 2013
<i>Drejtimi dhe Aksionerët</i>		
<i>Aktive</i>		
Te arketueshme nga Riviera Shpk	1,001,251	1,674,559
Parapagime për Dallandyshja Travel	2,566	-
Te arketueshme nga Aulona Pol 1 Shpk	248,820	-
Te arketueshme nga shareholder	1,392,105	-
<i>Liabilities</i>		
Te pagueshme ndaj Riviera Shpk	2,161,674	1,135,547
Te pagueshme ndaj Aulona Pol 1	461,700	1,748,980
Te pagueshme ndaj Hotel Riviera	4,500	-
Te pagueshme ndaj shareholder	-	103,453,655

35. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera domethënëse që do të kërkonin axhustim apo paraqitje në këto pasqyrat financiare.

SKEDULE SUPLEMENTARE

1. MARZHI I AFTËSISË PAGUESE

Marzhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën kapitalit neto më 31 dhjetor 2014 përbëhet si më poshtë:

b) Niveli aktual i aftësisë paguese:

Kapitali aksioner i paguar	756,108,491
Rezerva e sigurisë	16,891,912
Fitimet e mbajtura	(146,870,558)
Aktive të paprekshme	(1,943,080)
Llogari të arketueshme nga sigurimet dhe te tjera	(84,503,570)
Inventari	(26,651,990)
Aktive te tjera	(76,964,722)

Niveli aktual i marzhit të aftësisë paguese

436,066,483

2. AKTIVE PËR MBULIMIN E DETYRIMEVE TË SIGURIMIT

Në përputhje me nenin 96 dhe 97 të ligjit të sigurimit nr. 52 datë 22 Maj 2014, shoqëritë e sigurimit që operojnë në Shqipëri nuk mund të investojnë më shumë se raportet e mëposhtme të aktiveve dhe investimeve që mbulojnë rezervat teknike dhe matematike:

31 December 2014

Provigjionet bruto teknike dhe matematike

	Limiti i investment si përqindje e provigjionit bruto	Limiti i investimit sipas ligjit	Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit
Zëri i vetëm tokë dhe ndërtesa	10% për cdo ndertese	48,421,472	145,264,416
Depozita me afat e bono (duke përjashtuar fondin e garancisë)	pa limit	pa limit	149,306,580
Aktive të risigurimit (klasifikimi mbi BBB-)	pa limit	pa limit	13,334,505
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme (më pak se 3 muaj)	20%	96,842,944	11,531,648
Mjete monetare dhe ekuivalentë	3%	14,526,442	11,976,098
Investime në aktive fikse të ndryshme nga toka dhe ndërtesat	5%	24,210,736	24,040,825
Aktive të tjera	2%	9,684,294	9,684,294
Interes i llogaritur	5%	24,210,736	4,412,925
Totali			369,551,291
Shkalla e mbulimit në përqindje			76%